



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

Numri i lëndës: 2024:045881

Datë: 31.10.2024

Numri i dokumentit: 06382877

Kom.Dh.Shk.II.nr. 1318/2024

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dren Rogova, kryetar i kolegjit, Krenar Berisha Faton Bajrami, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit Adidas AG, Adi – Dassler-Strasse 1-2, Herzogenaurach, Gjermani, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve ‘Vokshi & Lata’, kundër të paditurit “SELO TOURS”, me NUI: 811851113, me seli në rrugën “Bajram Kelmendi”, Prishtinë, me objekt kontesti shkelje e markës tregtare, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurit të parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, KE.nr.2683/2022, të datës 30.04.2024, me datë 24.10.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar ankesa e të paditurës “SELO TOURS”, me NUI: 811851113, me seli në Prishtinë, NDRYSHOHET pika V. e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, KE.nr.2683/2022, të datës 30.04.2024, ashtu që vendoset si në vijim: “V. REFUZHET si e pabazuar pjesa e kërkesëpadisë së paditësit Adidas AG, Adi – Dassler-Strasse 1-2, Herzogenaurach, Gjermani me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri “SELO TOURS”, që paditësit, t’ia paguaj gjobën në shumën prej 5,000.00 € (pesë mijë euro) për shkak të shkeljes së markave tregtare të regjistruara të paditësit “Adidas”.
- II. REFUZHET ankesa e të paditurës “SELO TOURS”, me NUI: 811851113, me seli në rrugën “Bajram Kelmendi”, Prishtinë, për pikën I, II, III, IV dhe VI të aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, KE.nr.2683/2022, të datës 30.04.2024, ashtu i njëjti për këto pika të dispozitivit VËRTETOHET,

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar KE.nr.2683/2022 të datës 30.04.2024, Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vepruar si gjykatë e shkallës së parë ka vendosur si në vijim:

- I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Adidas AG dhe VËRTETOHET se i padituri “SELO TOURS”, përmes importimit të 88 palë patike dhe 50 kapele, ka shkelur markat tregtare të regjistruara të paditësit “Adidas”.
- II. I NDALOHET të paditurit që në të ardhmen të importoj apo në çfarëdo forme të tregtoj mallra që shkelin markat tregtare të paditësit “Adidas”.
- III. LEJOHET shkatërrimi i 88 palë patike dhe 50 kapele “Adidas”, që shkelin markën tregtare të paditësit dhe OBIGOHET i padituri që nën mbikëqyrjen doganore të bëjë shkatërrimin e mallit, në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.
- IV. OBLIGOHET i padituri që të mbuloj të gjitha shpenzimet e transportit, ruajtjes dhe magazinimi të mallrave si në pikën I të dispozitivit, në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.
- V. DETYROHET i padituri “SELO TOURS”, që paditësit, t’ia paguaj gjobën në shumën prej 5,000.00 € (pesë mijë euro) për shkak të shkeljes së markave tregtare të regjistruara të paditësit “Adidas”.
- VI. DETYROHET i padituri që paditësit t’ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën e përgjithshme prej 424.00 € (katërqind e njëzet e katër euro), në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë i padituri, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e të paditurit si e bazuar, të prishet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë ashtu që i njëjti t’i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka parashtruar paditësi.

Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e ankimuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të autorizuarit të paditurit është pjesërisht e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi Adidas AG, përmes të autorizuarit të tij, me datën 15.11.2022, ka paraqitur padi pranë Gjykatës Komerciale të Kosovës – Departamenti për Çështje Ekonomike, për shkelje të markës tregtare kundër të paditurit “SELO TOURS”, me të cilën ka kërkuar që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit dhe të vërtetohet se: i padituri ka shkelur markat tregtare të paditësit me numër regjistrimi 011824 dhe 011820; të i ndalohet të paditurit që në të ardhmen të importoj apo në çfarëdo forme të tregtoj mallra që shkelin markat tregtare të paditësit Adidas; të lejohet shkatërrimi i mallrave – 88 palë patike dhe 50 kapele, që shkelin markat tregtare të paditësit; të obligohet i padituri që nën mbikëqyrjen doganore të bëjë shkatërrimin e të gjitha mallrave të lartcekura; të obligohet i padituri që të mbuloj të gjitha shpenzimet e transportit, ruajtjes dhe magazinimi të mallrave si në pikën I të dispozitivit; të obligohet i padituri që paditësit të ia paguaj ndëshkimin në shumën prej 5000 €, si dhe t’i paguaj në tërësi shpenzimet e procedurës kontestimore në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështjet Ekonomike, pas shqyrtimit të secilës provë veç e veç dhe të gjitha provave së bashku, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, duke e aprovuar në tërësi kërkesëpadinë me arsyetimin se shenja që është përdorur në produktet e të paditurit është identike me markën tregtare të paditësit dhe se në rastin konkret shenjat e përdorura në mallrat e të paditurit nuk ka asnjë dyshim se shkaktojnë konfuzion në publik dhe secili konsumator do të krijoj bindjen se bëhet fjalë për produktet e paditësit. Përdorimi i paautorizuar i një marke tregtare, si e drejtë ekskluzive e pronarit të saj, përbën shkelje të markës tregtare. Sipas nenit 9 të LMT-së, shkelja mund të bëhet me çdo veprim të ndërmarrë pa autorizimin e pronarit, me të cilin atakohet të paktën njërën prej të drejtave të pronarit të markës tregtare. Kjo shkelje mund të bëhet gjatë kohës së vlefshmërisë së markës tregtare, brenda territorit për të cilën ajo është e autorizuar. Andaj, gjykata e shkallës së parë ka ardhur në përfundim se në rastin konkret, nga shkresat e lëndës rezulton si jokontestues fakti se importimi i mallrave kontestuese nga i padituri, të cilat nuk janë mallra të prodhuara nga paditësi, e në të cilat mallra është përdorur shenja identike me markat tregtare të regjistruara të paditësit, përbën shkelje të markës tregtare.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, përpos në pikën V të dispozitivit të aktgjykimit, pasi që aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) të LPK-së, pasi që e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu në aktgjykimin e ankimuar nuk është bërë konstatimi i gabuar apo jo i plotë i gjendjes faktike, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, ngase bazuar në provat përkatëse të lëndës ka vlerësuar se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të autorizuarit të të paditurit lidhur me konstatimin e gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, sepse gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike lidhur me bazën juridike të kërkesëpadiës për faktin se në mënyrë të pakontestueshme është vërtetuar se i padituri në mënyrë të jashtëligjshme dhe të paautorizuar ka bërë futjen e mallit në fjalë në territorin e Republikës së Kosovës, i cili mall ka përmbajtur në vete markën tregtare të paditësit të regjistruar në Republikën e Kosovës. Si rrjedhojë e këtij veprimi, i padituri ka shkelur të drejtën e markës tregtare të paditësit.

Gjykata e ankimuar vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërtënie me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë.

Gjykata e shkallës së dytë pas vlerësimit të pretendimit ankimor të autorizuarit të palës së paditur, në lidhje me faktin se malli është ndaluar në Doganë dhe i padituri nuk e ka pranuar asnjëherë mallin dhe se ky mall nuk ka dal në qarkullim, për Kolegjin nuk paraqet pretendim ankimor të bazuar për të vendosur ndryshe. Kjo për faktin se me Nenin 9 të LMT pronari i markës tregtare

gëzon mbrojtje duke iu mundësuar edhe e drejta e ndalimit të vendosë mallin me markën e mbrojtur, përfshirë këtu importin, transitin etj. Pra është evident fakti se nuk nënkupton medoemos se paditësi ka pasur të drejtë të gëzojë mbrojtje vetëm me faktin e vendosjes së produktit në treg apo kryerjen e importit por edhe ndalimin para se produkti të importohet. Rrjedhimisht, pretendimet ankimore të paditurës se malli është ndaluar para importimit, nën pretekstin senuk është vendosur në treg nuk ndryshon gjendjen faktike e as nuk i jep të drejtë të paditurës në një vendim ndryshe. Sipas Kolegjit, aspektet procedurale të mënyrës së vënies së produktit në treg, qoftë përmes importit apo deri në fazën e importit nuk bëjnë ndryshim në gëzimin e të drejtave absolute të markave tregtare.

Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, ngase bazuar në provat përkatëse të lëndës ka vlerësuar se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të autorizuarit të paditurit lidhur me konstatimin e gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, sepse gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike lidhur me bazën juridike të kërkesëpadisë për faktin se në mënyrë të pakontestueshme është vërtetuar se i padituri në mënyrë të paautorizuar ka bërë futjen e mallit në fjalë në territorin e Republikës së Kosovës, i cili mall ka përmbajtur në vete markën tregtare të paditësit të regjistruar në Republikën e Kosovës. Si rrjedhojë e këtij veprimi, i padituri ka shkëlur të drejtën e markës tregtare të paditësit.

Sipas Nenit 8 të Ligjit Nr. 04/L-026 Për Markat Tregtare (LMT), i aplikueshëm në rastin konkret, të drejtat nga markat tregtare konsiderohen të drejta pronësore dhe të njëjtat përbëjnë të drejta absolute. Kjo nënkupton se të gjitha palët e treta obligohen që të përmbahen nga përdorimi i paautorizuar i markës tregtare të regjistruar. Titullar i markës tregtare mund t'i ndalojë palët e treta që pa pëlqimin e tij të përdorin shenjën identike ose të ngjashme për mallrat apo shërbimet të llojit të njëjtë ose të ngjashme. Me regjistrimin e një marke të caktuar, bartësi i markës tregtare fiton të drejtën ekskluzive mbi markën tregtare.

Kolegji sa i përket pretendimit ankimor për vendosjen e gjobës nga pika V e dispozitivit, vlerëson se qëndron pretendimi ankimor i të paditurës se gjykata e shkallës së parë nuk ka përcaktuar afatin e brenda të cilit duhet paguar gjoba – gjë që e bën këtë pikë të dispozitivit të paekzaminueshëm. Dhomat e Shkallës së Dytë, si gjykatë e shkallës së dytë ka vlerësuar ndryshe faktet e çështjes në raport me gjykimin në shkallë të parë sa i përket kërkesës për caktimin e gjobës në shumë prej 5,000€. Kolegji vlerëson se vendosja e gjobës në kuptim të dispozitave të Nenit 75 par4 të LMT-së e aplikuar nga gjykata e shkallës së parë nuk përmban asnjë arsye për vendosjen si në pikën V të dispozitivit. Rrjedhimisht, kjo gjykatë duke i shqyrtuar provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës vlerëson se vendosja e gjobës me kërkesë të paditësit nuk është vlerësuar në mënyrë proporcionale në raport me kërkesat tjera, duke i vënë barrë joproportionale të paditurës në raport me shkeljen. Sipas gjykatës së shkallës së dytë, vendosja e gjobës ka për qëllim ndalimin e vazhdimin të shkeljes, e që në rastin konkret fare nuk janë dhënë arsye se cili ka qenë motivi për vendosjen e gjobës duke pasur parasysh se tashmë me pikën II të dispozitivit të padituri i është ndaluar që në të ardhmen të importojë apo në çfarëdo forme të tregtojë markat e paditësit. Po ashtu me pikën III të dispozitivit është lejuar shkatërrimi i mallrave ndërkaq për shpenzimet i padituri është obliguar t'i bartë i paditurit. Sipas Kolegjit të gjitha këto detyrime janë të mjaftueshme për të parandaluar vazhdimin e shkeljes, ndërsa gjoba eventualisht do t'i

shërbente rasteve kur shkelja e markës do të përsëritej përkundër masave të ndërmarra si përsëritje e shkeljes. Andaj, bazuar në shkresat e lëndës, kjo gjykatë duke vlerësuar ndryshe faktet e çështjes ka konstatuar gjendje tjetër faktike sa i përket pjesës së kërkesëpadiës që i referohet vendosjes së gjobës në shumë prej 5,000€, andaj lidhur me pikën V të dispozitivit të aktgjykimit ka vendosur që të aprovohet ankesa dhe të ndryshohet aktgjykimi i atakuar vetëm sa i përket pikës V të dispozitivit ashtu që për këtë pjesë të refuzohet kërkesëpadia.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallë së Dytë i ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera ankimore të autorizuarit të paditësit, por ka gjetur se të njëjtat kanë qenë të pabazuara, të pa argumentuara dhe pa ndikim për vendosjen ndryshe nga siç është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga sa u tha më lartë, Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallë së Dytë, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 para. 1, pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendosë si në dispozitiv.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë,
Kom.Dh.Shk.II.nr. 1318/2024, me datë 24.10.2024

Kryetari i Kolegjit, gjyqtari
Dren Rogova